

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-153/11

Prishtinë, 31 maj 2012

Në çështjen e:

N.D.

Parashtruesja e kërkesës/Pala ankuese

Kundër

1. **I.A.**

2. **H.I.**

3. **J.K.**

4. **H.O.**

5. **F.G.**

6. **K.K.**

7. **I.K.**

8. **B.D.**

9. **H.R.**

10. **B.A.**

11. **A.I.**

Palët përgjegjëse në kërkesë/Palët Përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/ACR/91/2010 (lëndët janë të regjistruara në AKP me numrat KPA50357 dhe KPA 90789 deri KPA90807), i datës 2 shtator 2010, pas shqyrtimit të mbajtur me 31 maj 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesa e paraqitur nga N.D. refuzohet si e pabazuar.
- 2- Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/ACR/91/2010, i datës 2 shtator 2010, për sa i takon lëndëve të regjistruara me numrat KPA50357 dhe KPA90789 deri KPA90807.

- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 530 (pesëqind e tridhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

Më 8 nëntor 2007, N.D. ka parashtruar një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku kërkonte të njihet si pronare e pronës që gjindet në Prishtinë, Veternik, duke kërkuar ri-posedim. Ngastra nr. 1649 e kërkuar është një arë e klasës së 4-të me një sipërfaqe prej 1 h 12 ari 82 m² e cila pjesërisht është shfrytëzuar për ndërtim. Parashtruesja e kërkesës ka shpjeguar se ajo ka fituar këtë tokë me trashëgimi, se ajo e kishte humbur atë më 12 qershor 1999 dhe se humbja ka qenë rezultat i rrethanave 1998/1999 në Kosovë. Ajo ka deklaruar se prona ishte uzurpuar dhe se një numër i shtëpive ishin ndërtuar ilegalisht në ngastër. Për të mbështetur pretendimin e saj, parashtruesja e kërkesës i kishte ofruar AKP-së dokumentet vijuese:

- Listën Poseduese nr. 11063, e lëshuar nga Komuna e Prishtinës, Zona Kadastrale Prishtinë, më 22 tetor 2004 (UNMIK), që konstaton se N.D. (X.N.) ka qenë në posedim të parcelës kontestuese nr. 1649;
- Planin kadastral për sa i takon Listës Poseduese nr. 11063, i lëshuar më 10 dhjetor 2004 nga Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër i Prishtinës që paraqet në mes tjerash formën dhe lokacionin e ngastrës nr. 1649;
- Aktgjykimin C. nr. 680/94 i Gjykatës Komunale e Prishtinës i datës 26 shtator 1997, me të cilin është vërtetuar se kontratat mbi shitjen e pronës OV nr. 638/64 e datës 30 prill 1964 dhe OV nr. 1741/67 e datës 19 shtator 1967, të lidhura në mes të Apostolović Manasija nga Prishtina dhe V. “W.” nga Prishtina ishin të pavlefshme. Prandaj, pala e parë përgjegjëse në kërkesë, “Z.” Y. nga Llapllasella ishte e obliguar t’i kthej në posedim dhe pronësi palës së dytë përgjegjëse në kërkesë, N.D. nga Prishtina, Parashtruesës së kërkesës, në mes tjerash ngastrën e pronës së paluajtshme nr. 1649, arë e klasës së 4-të me sipërfaqe prej 1 h 12 ari 82 m². Prona ishte e regjistruar si pronë shoqërore, e shfrytëzuar nga P. (A.) “K.”. Sipas aktgjykimit, e ndjera A.M., paraardhësja ligjore e N.D., më 19 shtator 1967 kishte lidhur me “W.”, paraardhësin ligjor të “Z.” Y., një kontratë me të cilën ajo kishte shitur – në mes tjerash – ngastrën nr. 9/3 e cila tani është e regjistruar si ngastra nr. 1649. Pas dëgjimit së disa dëshmitarëve, Gjykata Komunale ka gjetur se “Z.” Y. kishte bërë presion mbi A.M. në formë të shantazhimit dhe kërcënimeve që ta detyroj atë që t’ia shes pronën “W.”-it.

Lista e dorëzuar poseduese nr. 11063 ka mundur të verifikohet. Parashtruesja e kërkesës ka qenë e regjistruar si poseduese e ngastrave sipas aktgjykimit nr. 680/94 të datës 26 shtator 1997. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ishte e regjistruar si pronare/poseduese e pronës në bazë të Certifikatës për të Drejtat mbi Pronën e Paluajtshme të lëshuar më 24 mars 2009 nga Zyra Kadastrale e Komunës së Prishtinës - UL-71914059-11063.

Më 2 mars 2009, AKP-ja ka informuar parashtruesen e kërkesës se kërkesa e saj origjinale (KPA50357) ishte ndarë në 23 kërkesa të ndryshme (KPA50357 dhe KPA90789 deri KPA90810) pasi që në pronë ishin gjetur shumë shtëpi. Gjykata Supreme nuk është në gjendje të përcaktoj vendndodhjen e këtyre pjesëve të ndryshme të ngastrës nga përmbajta e lëndëve, pjesa e arsytimit të aktgjykimit, megjithatë, do të paraqes se në lidhje me këtë lëndë nuk ka qenë e domosdoshme të kërkohet informacion shtesë nga AKP-ja. Gjykata dëshiron të shtoj se vendimi i apeluar i KKKP-së merret vetëm me 20 lëndë të ndryshme (KPA50357 dhe KPA90789 deri KPA90807). Rrjedhimisht, vetëm këto lëndë mbulohen me këtë vendim të Kolegjit të Apelit të AKP-së.

Kur zyrtarët e AKP-së pyetën parashtruesen e kërkesës nëse ajo e kishte shfrytëzuar ndonjëherë pronën, parashtruesja e kërkesës i kishte informuar ata se pasi që ajo kishte marrë vendimin e gjykatës të vitit 1997, ajo kishte shkuar në ngastër dhe kishte parë se tre apo katër shtëpi ishin ndërtuar aty.

Gjykata do të përshkruaj faktet e mbetura sipas lëndëve tjera:

1. GSK-KPA-A-153/11(KPA50357):

Më 10 korrik 2008, ekipi i AKP-së për notifikim kishte shkuar në vendin ku pretendohet se ndodhej ngastra e kërkuar dhe kishte vendosur një shenjë që tregonte se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duheshin të dorëzonin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Zyrtarët e AKP-së vërejtën se prona ishte e zënë dhe se 22 shtëpi ishin të ndërtuara në të. Banorët lokal deklaruan se ata kishin blerë pronën njëzet vite më parë nga kompania “Z”.

Më 9 mars 2010 ishte verifikuar notifikimi i 2008-ës. Megjithëse pika notifikuese ishte gjetur të ishte 1 m pa ngastër, notifikimi ishte konsideruar se ishte bërë në mënyrën e duhur.

2. GSK-KPA-A-154 (KPA90789)

GSK-KPA-A-155 (KPA90790)

GSK-KPA-A-156 (KPA90791):

Më 22 dhjetor 2008 (mbase pas ndarjes së lëndëve), ekipi notifikues i AKP-së përsëri kishte shkuar


në vendin ku ngastra e kërkuar supozohej të ndodhej dhe kishin vendosur në disa pjesë të ngastrës disa shenja që tregonin se prona ishte subjekt i kërkesës dhe se palët e interesuara duhej të dorëzonin përgjigjet e tyre brenda 30 ditësh. Ata gjetën se prona ishte e uzurpuar nga I.A. i cili kishte ndërtuar disa shtëpi në ngastër.

Notifikimi ishte verifikuar më 3 mars 2010 dhe ishte konstatuar se ishte kryer në mënyrën e duhur.

Më 16 janar 2009, I.A. ishte paraqitur në AKP dhe kishte thënë se babai i tij kishte blerë pronën në vitin 1974. Pasi që babai i tij kishte vdekur në vitin 1976, fillimisht ata nuk e dinin se kush kishte qenë shitësi. Vet I.A. e kishte shfrytëzuar ngastrën që nga viti 1980 dhe në atë kohë e kishte ndërtuar shtëpinë e tij. Një tjetër objekt ishte ndërtuar në vitin 1984. Pala përgjegjëse në kërkesë kishte shpjeguar për më tepër se në vitin 1994 ai kishte një kontest gjyqësor me pronarin e ngastrës që në atë kohë ishte "Z". Sipas urdhrit të gjykatës, ai ka qenë i obliguar të paguaj kompensim për "Z", gjë të cilën ai e kishte bërë. Në vitin 1997, pala përgjegjëse në kërkesë kishte bërë një ankesë kundër vendimit të gjykatës në Gjykatën e Qarkut. Gjykata e Qarkut e kishte anuluar vendimin dhe e kishte kthyer lëndën në rigjykim. Edhe pse supozohet se pala përgjegjëse në kërkesë i kishte plotësuar obligimet e tij ndaj "Z", atij nuk i ishte lejuar të bartte pronën në emrin e vet.

I.A. ka dorëzuar në mes tjerash dokumentet vijuese në AKP:

- Aktgjykimin nr. 1266/1994, i lëshuar më 3 korrik 1997 nga Gjykata Komonale e Prishtinës, sipas të cilit "Z" nga Llapllasella ishte i vetmi pronar i ngastrës nr. 1649 ndërsa I.A., S.A. dhe D.I. ishin obliguar të lirojnë pronën; I.A. dhe S.A. duhej të paguanin 25.000 Dinarë për hapësirën prej 0.15.00 ha, D.I. 20.400 Dinarë për hapësirën prej 0.06.00 ha ku ata kishin ndërtuar shtëpitë për banim;
- Aktvendimin nr. 1073/97, i datës 24 dhjetor 1997 nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë, sipas të cilit aktgjykimi i sipërpërmendur ishte anuluar dhe dërguar në rigjykim; Gjykata e Qarkut kishte gjetur se Kontrata nr. 638/64 e datës 3 prill 1964 nuk ishte e mjaftueshme për të dëshmuar se "Z" ishte pronar sepse sipas kontratës "Z" jo por P. "K." e kishte blerë ngastrën.;
- Raportin e ekspertit, përgatitur më 13 shtator 1995 nga topografi "P." (pjesa e tjetër e emrit të tij nuk është e lexueshme) për procedurat para Gjykatës Komonale; sipas këtij raporti tre shtëpi ishin ndërtuar në ngastrën nr. 1649 nga I.A., S.A. dhe D.I., një pjesë tjetër ishte zënë nga I.K. si kopsht për patate dhe qepë; eksperti kishte bashkangjitur një skicë e cila tregonte ngastrën dhe pjesët e zëna.



Tre shtëpitë me aneks-objektet që I.A. ka ndërtuar përfshijnë sot më shumë hapësirë të pjesës jugore të ngastrës se sa që tregohet në këtë skicë; shtëpia e parë qëndron afërsisht 600 m në lindje të skajit perëndimor të ngastrës.

3. GSK-KPA-A-157/11 (KPA90792)

GSK-KPA-A-158/11 (KPA90792):

Këto lëndë i përkasin pjesëve të ngastrës në lindje të objekteve të ndërtuara nga I.A.. Notifikimi ishte bërë në të njëjtën kohë si në lëndët GSK-KPA-A-154 deri GSK-KPA-A-156 dhe përmes një verifikimi të mëvonshëm ishte konstatuar se ai ishte kryer në rregull. Këto pjesë të ngastrës ishin gjetur të zëna por jo të kultivuara. Askush nuk ishte përgjigjur ndaj kërkesës.

4. GSK-KPA-A-159/11 (KPA90794):

Gjithashtu më 22 dhjetor 2008, ekipi i AKP-së e kishte vendosur shenjën e notifikimit në këtë pjesë të ngastrës. Në këtë pjesë ekipi kishte gjetur një shtëpi të ndërtuar rishtazi, uzurpatorja ishte H.I. e cila pretendonte të drejtën ligjore ndaj pronës por refuzoj të nënshkruaj një shënim për pjesëmarrje në procedurë.

5. GSK-KPA-160/11 (KPA90795)

GSK-KPA-A-171/11 (KPA90806):

Pasi që ekipi notifikues njoftoi uzurpatorët e këtyre pjesëve të ngastrës, ata gjetën një shtëpi të ndërtuar rishtazi - GSK-KPA-160/11 (KPA90795) – si dhe një shtëpi e cila mbase ishte ndërtuar para kësaj shtëpisë së re - GSK-KPA-A-171/11 (KPA90806). J.K. pretendonte të drejtën ligjore mbi pronën. Verifikimi i mëvonshëm provoi se notifikimi ishte kryer në mënyrën e duhur.

Më 20 janar 2009, J.K. ishte paraqitur në AKP dhe kishte dhënë këtë shpjegim: Në vitin 1985 S.K., babai i tij, kishte blerë 1,5 ari nga një person i cili ishte i panjohur për J.K.. Në vitin 1986 S.K. kishte ndërtuar një shtëpi. Në vitin 1995, S.K. kishte blerë edhe 4 ari nga P. Q.. Ai tha se dokumentet ishin djegur në vitin 1999 gjatë luftës në fshatin Mramor dhe se një shtëpi disakatëshe ishte ndërtuar në vitin 2000. Ai përmendi disa dëshmitarë për këtë deklaratë, djali i tij konfirmoj deklaratën me shkrim.

Për të mbështetur parashtrësën e tij ai i paraqiti AKP-së një numër të faturave tatimore që qartazi i takonin pronave të ndryshme si dhe disa fatura dhe dëftesa tjera.. Gjithashtu, ai deklaroi se së bashku me të atin, axhën e tij, G.G., ka blerë tokën (shih deklaratën me shkrim në lidhje me lëndën GSK-KPA-A-162/11 (KPA90797)).

6. GSK-KPA-161/11 (KPA90796):

Gjatë kryerjes së njoftimit të kësaj kërkesë më 22 dhjetor 2008, zyrtarët e AKP-së gjetën një shtëpi sapo të ndërtuar në këtë pjesë të ngastrës. H.O. pretendoi të drejtën ligjore mbi pronën.

Më 20 janar 2009, H.O. ishte paraqitur në AKP dhe kishte dhënë deklaratën e tij të cilën ai e kishte përfunduar më vonë gjatë procedurës. Ai shpjegoi se në vitin 1995, ai e kishte blerë pronën me një sipërfaqe prej 1,9 ari nga ish -"P." (A.) përmes fqinjit të tij të ndjerë S.K.. G.G. gjithashtu ishte përfshirë. Si ish-drejtor i P, T., nuk kishte përmbushur obligimet e veta, bartja nuk ishte kryer. H.O. ka theksuar se ai ishte pronari i shtëpisë së ndërtuar në vitin 2000.

In 2010, H.O. kishte dorëzuar në AKP dokumentacionin në lidhje me një lëndë që ishte e pazgjidhur në Gjykatën Komonale të Prishtinës (C. Nr. 1582/08). Këto dokumente tregojnë se parashtruesja e kërkesës, N.D. në vitin 2008 kishte paraqitur një padi kundër uzurpatorëve të ngastrës nr. 1649 (kërkesat, megjithatë, shpesh i referohen ngastrës nr. 1619), duke kërkuar dëbimin dhe kompensimin e dëmit.

7. GSK-KPA-A-162/11 (KPA90797):

Pas notifikimit, i cili ishte kryer në mënyrën e duhur më 22 dhjetor 2008, F.G., i cili e kishte uzurpuar këtë pjesë të ngastrës, ishte paraqitur në AKP më 20 janar 2009 dhe e kishte konfirmuar deklaratën e

H.O.. Ai ka sqaruar se G.G. e kishte blerë tokën së bashku me S.K. dhe H.O.. Si ish-drejtor i P.-së T. nuk e kishte përmbushur obligimin e vet, bartja nuk ishte kryer. Në vitin 2000 ishte ndërtuar një shtëpi me dy dhoma, në vitin 2004 ishte ndërtuar një shtëpi dykatëshe. F.G. gjithashtu kishte dorëzuar dokumente në lidhje me padinë e parashtrueses së kërkesës kundër uzurpatorëve të ngastrës nga të cilat konstaton se babai i tij, G.G., kishte blerë një pjesë të ngastrës me një sipërfaqe prej 2,5 ari.

8. GSK-KPA-A-163/11 (KPA90798):

Notifikimi i kësaj pjese të ngastrës është bërë më 2 prill 2009. Ekipi notifikues i AKP-së kishte gjetur një shtëpi të ndërtuar rishtazi. Përkundër notifikimit, askush nuk ishte përgjegjës ndaj kërkesës. Notifikimi ishte verifikuar më 11 shkurt 2010 dhe ishte gjetur se ai ishte kryer në mënyrën e duhur.

9. GSK-KPA-A-164/11 (KPA90799):

Notifikimi i kësaj pjese të ngastrës është bërë më 23 mars 2009. Ekipi notifikues i AKP-së gjeti një dyqan të ndërtuar rishtazi. Banorët lokal i kishin thënë zyrtarëve të AKP-së se personi që kishte uzurpuar pronën jetonte jashtë. Përkundër notifikimit, askush nuk ishte përgjegjës ndaj kërkesës. Notifikimi ishte verifikuar më 11 shkurt 2010 dhe ishte konstatuar se ai ishte kryer në mënyrën e duhur.

10. GSK-KPA-A-165/11 (KPA90800):

Gjatë notifikimit, i cili ishte kryer në mënyrën e duhur më 22 dhjetor 2008, ishte konstatuar se prona ishte e uzurpuar nga K.K.. K.K. ka deklaruar se ka të drejtë ligjore mbi pronën dhe se ai përfaqësohej nga avokati i tij. Ai refuzoj të jap më shumë informacion për AKP-në.

11. GSK-KPA-A-166/11 (KPA90801):

Notifikimi ishte bërë në mënyrën e duhur më 22 dhjetor 2008. Ishte konstatuar se prona ishte e uzurpuar nga I.K. i cili së fundmi kishte ndërtuar një shtëpi në këtë pronë dhe deklaroi se kishte të drejtë ligjore mbi pronën. Ai nuk kishte dhënë më shumë informacion për AKP-në.

12. GSK-KPA-A-167/11 (KPA90802)

GSK-KPA-A-168/11 (KPA90803):

Notifikimi është kryer në mënyrën e duhur më 22 dhjetor 2008. Ekipi notifikues i AKP-së gjeti dy shtëpi të ndërtuara rishtazi, uzurpatori, B.D., pretendonte të drejtën ligjore ndaj pronës.

13. GSK-KPA-A-169/11 (KPA90804):

Gjithashtu më 22 dhjetor 2008, zyrtarët e AKP-së kishin shkuar në pjesën e ngastrës e cila ishte objekt i kësaj kërkesë. Notifikimi ishte kryer në mënyrën e duhur. Zyrtarët kishin gjetur një shtëpi të ndërtuar rishtazi. Uzurpatori, H.R., tha se ai kishte të drejtë ligjore ndaj pronës.

Më 3 mars 2009, H.R. i kishte shpjeguar AKP-së se ai kishte blerë pronën nga N.S. nga fshati Leshkoshiq i Komunës së Obiliqit më 25 shtator 2000 për 48.000 marka gjermane. H.R. ka deklaruar se N.S. i ka garantuar atij se prona ishte e tija dhe se në rast se prona merrej nga H.R. ai, N.S., do ta kompensonte atë me apartamentin e tij. Ai ka dorëzuar një kontratë të shitblerjes përmbajtja e së cilës mbështetë deklaratën e tij.

14. GSK-KPA-A-170/11 (KPA90805):

Notifikimi ishte bërë në mënyrën e duhur më 22 dhjetor 2008. Ekipi notifikues i AKP-së kishte gjetur një shtëpi të ndërtuar rishtazi. Uzurpatori, B.A., ka pretenduar të drejtën ligjore ndaj pronës por nuk ka ofruar më shumë informacion.

15. GSK-KPA-A-172/11 (KPA90807):

Ky notifikim gjithashtu ishte bërë në mënyrën e duhur më 22 dhjetor 2008. Në këtë pjesë të ngastrës ekipi notifikues i AKP-së prapë kishte gjetur një shtëpi të ndërtuar rishtazi. Uzurpatori, A.I., është përgjegjës ndaj kërkesës më 15 janar 2009. Ai i kishte shpjeguar AKP-së se ata e kanë shfrytëzuar pronën që nga vitet e 70-ta dhe kanë filluar të jetojnë në të në vitin 1980. Ai i ka dorëzuar disa fatura /pagesa për rrymë si dhe një Certifikatë të Vdekjes që tregon se I.I. kishte vdekur më 1 mars 1986.

Nga këto deklarata, Gjykata nxjerr faktet vijuese:

Në vitin 1964 prona e kërkuar ishte shitur nga M.A. për ndërmarrjen shoqërore K.. Me aktgjykimin nr. 680/94 të datës 26 shtator 1997 Gjykata Komunale e Prishtinës kishte anuluar kontratat e blerjes dhe i kishte kthyer pronën kontestuese trashëgimtarit ligjor të M.A., domethënë Parashtrueses të kërkesës.

Megjithatë, qysh para vitit 1994 I.A., S.A. dhe D.I. kishin ndërtuar tre shtëpi në ngastër, një pjesë tjetër e ngastrës ishte uzurpuar nga I.K. si oborri (shih planin e paraqitur më lartë). Në vitin 1994 një ndërmarrje tjetër shoqërore, Z, kishte bërë një kërkesë kundër këtyre personave, ku theksonte të drejtën e saj pronësore për shkak të shitjes së pronës në vitin 1964 për K.. Me aktgjykimin nr. 1266/94 të datës 3 korrik 1997, Gjykata Komunale e Prishtinës kishte vendosur në dobi të Z. dhe kishte konstatuar se palët përgjegjëse në kërkesë ishin të obliguara të njohin kërkesën mbi pronësinë të Z.. Me aktgjykimin nr. 1073/97 të datës 24

dhjetor 1997, Gjykata e Qarkut e Prishtinës kishte anuluar pjesë të këtij vendimi pasi që ishte K. e jo Z., ajo që kishte siguruar të drejtën pronësore mbi ngastrën në vitin 1964.

Parashtruesja e kërkesës e kishte vizituar ngastrën në vitin 1997 dhe kishte gjetur tre apo katër shtëpi. Shtëpitë tjera ishin ndërtuar më vonë.

Më 2 shtator 2010, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin e vet KPCC/D/ACR/91/2010 ka hedhur poshtë kërkesat pasi që nuk binin në kuadër të mandatit të Komisionit. Komisioni kishte sqaruar se Parashtruesja e kërkesës nuk kishte qenë asnjëherë në posedim të pronës së kërkuar dhe se kontesti në lidhje me pronësinë mbi pronën datonte para konfliktit.

Vendimi i ishte dorëzuar Parashtrueses së kërkesës më 22 gusht 2011. Më 15 shtator 2011, Parashtruesja e kërkesës (tash e tutje: pala ankuese) kishte paraqitur një ankesë në Gjykatën Supreme që kundërshtonte vendimin e KKPK-së mbi bazën e vërtetimit të gabuar të fakteve dhe zbatimit të gabuar të së drejtës së aplikueshme materiale dhe procedurale.

Pala ankuese kishte theksuar se KKPK kishte vërtetuar faktet në mënyrë të gabuar se ajo nuk kishte qenë asnjëherë në posedim të pronës. Vendimi i Gjykatës Komunale të Prishtinës nr. P-680/94 ishte bërë i plotfuqishëm më 28 tetor 1997. Pala ankuese thekson se vetëm për shkak të konfliktit të armatosur ajo nuk ka qenë në gjendje të regjistroj veten si pronare/poseduese e tokës në kadastër. Por ajo e bëri këtë më vonë. Kur ajo e kishte vizituar tokën në vitin 1997, tre apo katër shtëpi ishin ndërtuar në tokë. Pala ankuese është e mendimit se, si dhe në shumicën e tokave nuk ishte ndërtuar asnjë shtëpi, kjo tokë ishte “e lirë” dhe rrjedhimisht në posedim të saj. Pala ankuese thekson se duke e vizituar tokën dhe duke folur me uzurpatorët ajo në mënyrë aktive kishte marrë në posedim pjesën më të madhe të tokës ku nuk ishin ndërtuar shtëpi. Se kjo pjesë nuk ka qenë në posedim të uzurpatorëve konstatohet, sipas palës ankuese, nga fakti se më vonë njerëz të tjerë kishin ndërtuar shtëpitë e tyre në këto pjesë të ngastrës.

Gjithashtu pala ankuese thekson se nuk ka kontest të hapur në lidhje me tokën por se kontesti kishte përfunduar me vendimin final të Gjykatës Komunale të Prishtinës, nr. P-680/94, të datës 26 shtator 2010. Kontesti në gjykatën lokale ishte për të drejtën e saj për të rimarrë posedimin, jo për të drejtën e saj pronësore.

Pala ankuese kërkon që të pranohet ankesa dhe që të lëshohet një vendim që vërteton të drejtën e saj të ri-posedim të pronës..

Ankesa i ishte dorëzuar palëve përgjegjëse në kërkesë (tash e tutje: palëve përgjegjëse në ankesë). J.K., H.O. dhe F.G. ishin përgjigjur më 9 nëntor 2011. Ata i janë referuar procedurave të hapura në Gjykatën Komunale të Prishtinës dhe kërkuan që të pritet rezultati i këtyre procedurave para vendosjes në lidhje me lëndët.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa është e pranueshme. Ajo është bërë brenda periudhës 30 ditore që parashihet me Nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.

Megjithatë, ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë. Gjykata nuk ka gjetur as vërtetim jo të plotë të fakteve dhe as zbatim të gabuar të së drejtës materiale ose procedurale. Lënda nuk është në kuadër të kompetencave të KKPK-së.

Gjykata nuk vëren vërtetim të gabuar të fakteve. Për atë kohë sa pala ankuese vë në pikëpyetje vlerësimin e KKPK-së në lidhje me posedimin e saj të ngastrës, kjo nuk është çështje e vërtetimit të fakteve por një opinion në lidhje me një çështje ligjore. Thënë shkurt, çështja nëse pala ankuese e kishte në posedim ngastrën ose jo përbën një çështje ligjore dhe jo një çështje faktesh. Shprehja “posedim” është shprehje ligjore. Për të vërtetuar “posedimin” apo për ta mohuar atë kërkon një vlerësim ligjor i cili shkon shumë përtej vërtetimit të thjeshtë të fakteve. Edhe nëse – ndonjëherë– shprehjet ligjore mund të përdoren për të përshkruar faktet në mënyrë të shkurtër, kjo mund të bëhet vetëm në rastet ku shprehja ligjore është shumë e thjeshtë dhe nuk varet nga vlerësimi i komplikuar ligjor. Në rrethanat e këtij rasti, megjithatë, çështja nëse pala ankuese ka qenë në posedim të ngastrës apo të një pjese të saj është më shumë se e paqartë dhe do të kërkonte një vlerësim të thellë ligjor në lidhje me të, për shembull, nëse personat të cilët kanë ndërtuar shtëpitë donin të posedojnë më shumë se pjesën e ngastrës ku ishin ndërtuar shtëpitë e tyre (kjo është çështje e fakteve) apo nëse ata vetë ishin në posedim të më shumë se të këtyre pjesëve të ngastrave që tashmë posedonin sikur ta posedonin atë “për” apo “në vend të” palës ankuese (çështje e fakteve dhe interpretimit të tyre ligjor).

Për sa i takon pretendimeve të palës ankuese se kontesti që ka të bëjë me pronën ka përfunduar me një aktgjykim të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe se kontesti mes palëve tash ka të bëjë “vetëm me” të drejtën e saj të marr përsipër posedimin, jo pronësinë e saj, kjo ngjashëm nuk përbën vërtetim të gabuar të fakteve. KKPK-ja ka theksuar: ”Kontesti në lidhje me pronësinë mbi pronën daton para konfliktit dhe nuk mund të thuhet se përfshinë rrethana që direkt ndërlidhen me konfliktin e armatosur në Kosovë gjatë periudhës 1998 deri 1999 apo rezultojnë nga ai. Kontesti në thelb ndërlidhet me atë nëse Parashtruesja e kërkesës, ose ndërmarrja shoqërore, qoftë ajo K. apo Z. apo pasuesit e tyre, janë pronarët e tokës, dhe nëse

ndonjëri nga Palët përgjegjëse në kërkesë kanë fituar interes pronësie. Procesi gjyqësor në lidhje me çështjen e pronësisë së ngastrës ka vazhduar së paku që nga 1994, kur është paraqitur padia fillestare nga Parashtruesja e kërkesës, e deri në ditët e sotme. Që nga vitet 2006/2007 Parashtruesja e kërkesës ka ndërmarrë hapa për të ushtruar të drejtën e saj pronësore mbi ngastrën. Çdo pamundësi nga ana e Parashtrueses së kërkesës për të ushtruar aktualisht të drejtën e saj pronësore në lidhje me tokën është rezultat i procesit të stërzgatur gjyqësor në lidhje me pronësinë mbi pronës dhe jo rezultat i rrethanave që kanë të bëjnë me konfliktin”. Nga këto komente bëhet e qartë se KKPK nuk i ka vërtetuar faktet në mënyrë të gabuar. KKPK argumenton se konflikti në lidhje me ngastrën i ka rrënjët më herët se sa konflikti i armatosur në Kosovë. Nëse ky konflikt ka qenë në lidhje me pronësinë apo të drejtën e ri-posedimit nuk ka ndonjë rëndësi gjer tani. E vetmja çështje me rëndësi në këtë aspekt është çështja se kush i ka të drejtat (cilat do qofshin ato) ndaj kësaj ngastre të tokës. Nëse pala ankuese bën dallimin në mes të kontestit për pronësi dhe kontestit për të drejtën e ri-posedimit, ky dallim këtu është vetëm artificial dhe i konstruktuar.

Në fund, Gjykata konsideron se nuk ka pasur aplikim të gabuar të ligjit. Gjykata pajtohet se lëndët nuk janë në kuadër të kompetencave të KKPK-së.

Kompetencat e KKPK-së përcaktohen me Nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, i cili thotë se KKPK ka kompetenca të zgjidh *“kërkesat që ndërlidhen me konfliktin që përfshijnë rrethana që direkt ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në mes të datave 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999”*.

Gjykata Supreme konsideron se kushti “që ndërlidhet me konfliktin” nuk është përmbushur në rastin aktual dhe si pasojë e kësaj KKPK nuk kishte kompetencë lëndore mbi këtë lëndë.

Se a është një lëndë “e ndërlidhur me konfliktin” apo jo, duhet të vendoset në lidhje me origjinën dhe fokusimin kryesor të kontestit. Çështja nëse Parashtruesja e kërkesës ka qenë ndonjëherë (direkt apo indirekt, shih Nenet 103 dhe 109 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 4. gusht 2009) në posedim të ngastrës, është me rëndësi dytësore.

Në këtë rast, origjina e kontestit gjendet në kohën para konfliktit të armatosur të viteve 1998/1999. Që në vitin 1997, së paku tre persona të ndryshëm, anëtar të familjes të disa nga uzurpatorëve aktual, kishin kontest pronësor me Z. në lidhje me të drejtat pronësore/të drejtën e posedimit të pjesës më të madhe të ngastrës (shih vizatimin e mësipërm nga ekspertiza). Gjatë kohës së njëjtë, Parashtruesja e kërkesës kishte kontestuar (në mënyrë të suksesshme) të drejtën e K. ndaj ngastrës dhe në fund në vitin 1997 Parashtruesja e kërkesës kishte informuar të tre uzurpatorët mbi të drejtën e saj dhe kishte tentuar të arrijë një marrëveshje me ta.

Ky kontest kishte vazhduar kur personat e tjerë kishin ndërtuar shtëpitë e tyre në pjesët e tjera të ngastrës. Kjo është e qartë për anëtarët e familjeve dhe për fqinjët e tre uzurpatorëve të parë, të cilët tani pretendojnë të drejtë pronësie që buron nga e drejta e prindit të tyre apo fqinjit (GSK-KPA-A-154 deri GSK-KPS-A-156; GSK-KPA-A-160 dhe GSK-KPA-A-171; GSK-KPA-A-161; GSK-KPA-A-162 dhe GSK-KPA-A-172).

Gjithashtu në lidhje me uzurpatorët e tjerë, Gjykata nuk gjen shkelje të të drejtave pronësore të Parashtrueses së kërkesës, që do mund të vendoste kërkesat nën kompetencën e KKPK-së. Shkelja (e pretenduar) e të drejtave pronësore të Parashtrueses së kërkesës e cila është shkaktuar nga këto objekte, nuk mund të trajtohet ndaras nga shkelja e provokuar nga tre apo katër shtëpitë e para. Edhe nëse uzurpatorët kanë shfrytëzuar avantazhin e situatës jostabile që kishte rezultuar nga konflikti i armatosur në vitet 1998/1999, ndërtimi i më shumë shtëpive vetëm sa e ka acaruar shkeljen (e pretenduar) të së drejtave pronësore të Parashtrueses së kërkesës që tanimë kishte ndodhur para vitit 1997 dhe nuk kishte kurrfarë lidhje me konfliktin e armatosur.

Rrethana që në vitin 1994 tre uzurpatorët e parë kishin pretenduar të drejta ndaj pothuajse tërë ngastrës (shih vizatimin e mësipërm) është gjithashtu një argument ndaj vlerësimit se humbja e mundësisë nga Parashtruesja e kërkesës që të ushtroj të drejtat e saj vetëm sa ishte acaruar nga ndërtimet e mëvonshme dhe datonte qysh nga kjo kohë. Prandaj, kjo nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur të viteve 1998/1999.

Gjykata ka vërejtur gjithashtu se ekzistojnë pjesë të ngastrës ndaj të cilave askush nuk ka pretenduar të drejtë. Megjithatë, edhe nëse do të ishte e mundur të vendosej në lidhje me pjesët e një ngastre të pandarë pa i definuar saktësisht kufijtë e tyre – duke ngritur në këtë mënyrë çështjen e ekzekutimit të një vendimi të paqartë dhe pastaj edhe të ligjshmërisë – Gjykata abstenon nga marrja e vendimit për këto pjesë.

Pasi që lëndët nuk janë nën kompetencë të KKPK-së, procedurat në vazhdim e sipër në Gjykatën Komunale të Prishtinës nuk janë paraprake (Neni 13 Ligji nr. 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore), Gjykata nuk gjen arsye për të pezulluar rastin (kërkesë e palëve përgjegjëse në ankesë J.K., H.O. dhe F.G.).

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë aplikohet regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së,

3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit

Kështu që, tarifat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit::

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pasur parasysh se vlera e pronës së kërkuar me arsye mund të vlerësohet se kap vlerën mbi € 200,000: € 500 (€ 50 + 0,5% e € 200,000, por prapë jo më shumë se € 500).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 90 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47 paragrafi 3 parasheh që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet zbatimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë juridike

Në përputhje me Nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Filcheva - Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it